No. 17891

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

Nr.6252 datë 10.12.2001 Nr.3583 datë 27.11.2001

U D H E Z I M

PER PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONIN PER FITIMIN, RIFITIMIN DHE HEQJEN DORE NGA SHTETESIA SHQIPTARE

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 e Kushtetutes,per zbatim te ligjit nr. 8389, date 05.08.1998 "Per shtetesine shqiptare",me qellim qe te unifikohet praktika per shtetesine shqiptare ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise,

U D H E Z O J M E :

1.Aplikimi nga shtetas te huaj ose shqiptare per fitimi, rifitim ose heqje dore nga shtetesia shqiptare behet ne komisariat te policise vendore ku aplikuesi ka te regjistruar gjendjen civile.
Per shtetasit e huaj,apo shqiptare,qe banojne jashte shtetit aplikimi behet ne perfaqesine diplomatike ose konsullore te Republikes se Shqiperise ne vendin e rezidences se tij,ose ate ne vendin me te pershtatshem per te,kur ne vendin e rezidences se tij nuk ka perfaqesi te tille Republika e Shqiperise.

2.Ne komisariatin e policise vendore,punonjesi i caktuar per te huajt dhe pasaporten pret aplikantet per fitim,rifitim ose heqje dore nga shtetesia

shqiptare,u kontrollon atyre dokumentet per shtetesine shqipetare dhe kur i gjen ato te plota e te rregullta ben pranimin e tyre kundrejt pageses ne arke. Perfaqesia diplomatike apo konsullore dergon,me posten e shpejte,ne Ministrine e Puneve te Jashtme praktikat per shtetesine shqiptare ne afatin kohor prej 10 ditesh.

3.Punonjesi i policise se shtetit,ose ai i perfaqesise diplomatike-konsullore mban pergjegjesi per saktesine dhe rregullsine e dokumenteve qe u pranon aplikanteve.Per depozitimin e dokumenteve aplikanteve u leshohet vertetimi zyrtar konform me lidhjen 1,2 ose lidhjen 3,sipas qellimit te aplikimit.

4.Komisariati i policise vendore,punonjesi i caktuar,ben studimin e dokumenteve te aplikantit,verifikimet e nevojshme ne Gjykate,Zyren e Permbarimit,Prokurori,Zyren e Gjendjes Civile,Njesine administrative dhe Policine Kriminale.
Mbi bazen e perfundimeve te arritura punonjesi i caktuar pergatit ne nje flete te veçante mendimin e tij per secilin aplikant,te cilin,se bashku me dokumentet e mundshme, e dergon ne drejtorine e policise qarkut ne afatin kohor prej nje muaji,qe nga data e pranimit te dokumenteve.
Per te miturit e moshes 0-14 vjeç nuk kerkohet mendim ne flete te veçante.
Drejtoria e policise qarkut,pasi konfirmon rregullsine e dokumenteve te derguara nga komisariatet,brenda dy javesh,i percjell ne Drejtorine Qendrore te Policise Rendit.
Ne Drejtorine Qendrore te Policise Rendit,nga Sektori i Pasaportes dhe te Huajve kontrollohet saktesia dhe rregullsia e dokumenteve,behet vleresimi i tyre dhe mbi bazen e perfundimeve te arritura pergatitet vendimi i Ministrit te Rendit Publik per paraqitjen ose jo te kerkeses se aplikantit prane Presidentit te Republikes.
Drejtoria Qendrore e Policise Rendit mbyll praktiken per shtetesine shqiptare brenda nje muaji,nga data e mbrritjes se saj ne sekretari.

5.Ne rast se Kabineti i Presidentit kerkon dokumente (plotesime) te tjera,te pa normuara ne kete udhezim,Drejtoria Qendrore e Policise Rendit,ne afatet e percaktuara ne piken 6 te ketij udhezimi,ia kerkon ato drejtorise policise te qarkut,e cila brenda muajit duhet te ktheje pergjigjen perkatese.Pergjigja i dergohet menjehere Kabinetit te Presidentit.

6.Per aplikimet qe vine nepermjet Ministrise se Puneve te Jashtme,Drejtoria Qendrore e Policise Rendit,jo me shume se 6 dite pune nga data e mbrritjes

ne sekretari,kerkon zyrtarisht ne drejtorine respektive te policise qarkut, mendimin per kerkesen e aplikantit.Drejtoria pergatit ne nje flete te veçante mendimin e saj per kerkesen e aplikantit dhe jo me vone se nje muaj nga data e marrjes se njoftimit e dergon ate ne Drejtorine Qendrore te Policise Rendit.Mendimi i bashkelidhet praktikes te ardhur nga Ministria e Puneve te Jashtme.

7.Dokumentet qe kerkohen per shtetesine shqiptare:

a)*Per fitimin e shtetesise* :

- Me lindje :
Per femije te lindur jashte territorit te Republikes se Shqiperise,kur njeri prej prinderve eshte shtetas shqiptar ose femije te lindur ne territorin e Republikes se Shqiperise nga prinder me shtetesi te huaj,por qe te dy jane rezidente te ligjshem ne Republiken e Shqiperise :

- Kerkesa e prinderve drejtuar Presidentit te Republikes.Kerkesa te permbaje identitetin e plote te kerkuesve (emer mbiemer,datelindje, vendlindje,shtetesine),adresen e sakte te vendbanimit te tyre te perhershem dhe adresen (nr.telefoni) ku presin informim per ecurine e aplikimit te tij,arsyet e kerkeses per fitimin e shtetsise shqipetare. Kerkesa nenshkruhet me emer mbiemer e firme nga kerkuesit;
- Çertifikata e lindjes se femijes;
- Fotografi e femijes,cope tre.
- Çertifikata e cila percakton shtetesine e te dy prinderve;
- Deklarata noteriale e dy prinderve,ku te shprehet pelqimi i tyre per dhenien e shtetsise shqiptare femijes.

- *Me natyralizim* :

- Kerkesa e shtetasit te huaj drejtuar Presidentit te Republikes.Kerkesa te permbaje identitetin e plote te kerkuesit (emer mbiemer,datelindje, vendlindje,shtetesine), adresen e sakte te vendbanimit te tij te perhershem dhe adresen ku pret informim per ecurine e aplikimit te tij,arsyet e kerkeses per fitimin e shtetsise shqipetare.Kerkesa nenshkruhet me emer mbiemer e firme nga kerkuesi;
- Mendimi me shkrim te nepunesit qe pranon dokumentet per nivelin e njohurive te gjuhes shqipe;
- Çertifikata e lindjes;

- Lejeqendrimi ne Repuliken e Shqiperise,sipas kritereve te ligjit per shtetesine (fotokopje e noteruar),ne se banon ne Shqiperi;
- Akti i pronesise se baneses ose kontrata e zenies me qera te baneses (fotokopje e noteruar);
- Kontrate pune per te punesuarit ose vertetim nga Zyra e tatimeve per te vetpunesuarit ose investitoret (fotokopje e noteruar);
- Dokumente qe vertetojne disponimin e mjeteve financiare te mjaftueshsme per jetese si garanci bankare,libreze kursimi,vertetime zyrtare te ardhurash (fotokopje e noteruar);
- Deshmi penaliteti e marre ne vendin e origjines dhe ne vendin ku kerkuesi ka patur qendrim legal per gjashte muajt e fundit;
- Dokument qe verteton qenien azilant,nese eshte i tille (Fotokopje e noteruar);
- Mendim me shkrim i komisariatit te policise vendore per sjelljen dhe qendrimin e kerkuesit ne se banon ne Republiken e Shqiperise;
- Fotografi e aplikantit,cope tre (Ne rast se ka femije nen 14 vjeç,fotografi per secilin prej tyre).
- Çertifikate (kur eshte e nevojshme) per te vertetuar origjinen shqiptare te kerkuesit,deri ne dy shkalle,qofte dhe nga njeri prind.

b)*Per rifitimin e shtetesise shqiptare* :

Personi qe ka hequr dore nga shtetesia shqiptare per shkak te premtimit per fitimin e nje shtetesie tjeter,e rifiton shtetesine shqiptare ne qofte se nuk ka fituar shtetesine e premtuar.Ne keto raste paraqiten dokumentet vijuese:

- Kerkesa e qytetarit drejtuar Presidentit te Republikes. Kerkesa te permbaje identitetin e plote te kerkuesit (emer mbiemer,datelindje, vendlindje),numrin dhe daten e dekretit te Presidentit te Republikes nepermjet te cilit i eshte hequr shtetesia shqiptare,adresen e sakte te vendbanimit te tij te perhershem dhe adresen (nr.telefoni) ku pret informim per ecurine e aplikimit te tij,arsyet e kerkeses per rifitimin e shtetsise shqipetare.Kerkesa nenshkruhet me emer mbiemer e firme nga kerkuesi;
- Çertifikate lindje dhe familjare;
- Relacion spiegues dhe konfirmimi nga komisariati i policise vendore dhe prefektura perkatese lidhur me shtetesine qe kane ose kane patur prinderit e çdo aplikanti;

- Deklarate noteriale nga çdo aplikant mbi 14 vjeç per faktin e aplikimit ose jo per te fituar shtetsi tjeter;
- Vertetimin e njesise administrative perkatese per çdo aplikant mbi 14 vjeç;
- Çertifikaten e lindjes ose te vdekjes te prinderve te çdo aplikanti;
- Fotografi e aplikantit,cope tre (Ne rast se ka femije nen 14 vjeç,fotografi per secilin prej tyre).

c)*Per heqjen dore nga shtetesia* :

- Kerkesa e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit te Republikes.Kerkesa te permbaje identitetin e plote te kerkuesit (emer mbiemer,datelindje, vendlindje,kombesine),adresen e sakte te vendbanimit te tij te perhershem,si dhe adresen (nr.telefoni) ku pret informim per ecurine e aplikimit te tij,arsyet e kerkeses per heqjen dore nga shtetsia shqipetare.Kerkesa nenshkruhet me emer mbiemer e firme nga kerkuesi;
- Premtimi nga autoriteti kompetent i shtetesise tjeter ose dokument shtetesie origjinal,marre ne vendin perkates;
- Çertifikata e lindjes me fotografi e aplikuesit *;
- Çertifikata familjare e aplikuesit *;
- Vertetimi i gjendjes gjyqesore *;
- Vertetimi nga Gjykata e rrethit *;
- Vertetimi nga Prokuroia *;
- Vertetimi nga Zyra e Permbarimit *;
- Vertetimi nga Kryetari i Njesise administrative qe eshte banor i asaj njesie,ne te cilin te konfirmohet adresa e sakte *;
- Çertifikata e marteses se aplikantit e marre ne vendin ku eshte lidhur martesa;
- Çertifikata e gjendjes familjare ne shtetin ku banon;
- Deklarata noteriale e te dy prinderve,ku te shprehet pelqimi i tyre per heqjen dore nga shtetsia shqipetare e femijeve te tyre te moshes deri 18 vjeç;
- Dokumenti qe verteton rezidencen,vendbanimin e tij ne shtetin premtues te shtetsise tjeter.Ne çdo rast ky dokument duhet te jete per te gjithe antaret e familjes;

Dokumentet,te cilat kane shenjen "" te merren ne Republiken e Shqiperise.*

Ne te gjitha rastet fotografia te jete ne permasat 4x5 cm,e bere ne planin ballor,me balle te hapur,pamja deri ne mjeker te mbuloje 70 perqind te saj.
Te gjithe dokumentet e leshuara ne Republiken e Shqiperise pranohen kur jane te nenshkruara nga titullari i institucionit,qe i leshon ato.Per aplikantet e martuar dokumentet te permbajne te dy mbiemrat,ate te lindjes dhe pas marteses.

8.Aplikimet per shtetesine shqiptare jane individuale,veç te miturve deri ne moshen 14 vjeç,per te cilet shprehen prinderit e tyre.

9.Per femijet e lindur jashte territorit te Republikes se Shqiperise qe nuk kane perfituar shtetesi tjeter,aplikimet per heqje dore nga shtetesia shqiptare,pranohen kur ata jane regjistruar ne Zyren e Gjendjes Civile perkatese ne Shqiperi.Ne raste te tilla nga prinderit te depozitohen edhe çertifikata e lindjes e leshuar nga autoritet e vendit te lindjes se femijes.

10.Per te huajt,qe aplikojne per fitim (rifitim) te shtetesise shqiptare nga Drejtoria Qendrore e Policise Rendit merret mendimi i Drejtorise te Policise Kriminale dhe i Sherbimit Informativ Shteteror.

11.Te gjitha dokumentet e renditura,te normuara ne kete udhezim,pranohen kur jane origjinale (perveç atyre qe jane percaktuar fotokopje),te legalizuara secili me vete ne perfaqesine tone diplomatike apo konsullore ne vendin ku ato jane leshuar,te shqiperuara e noteruara,leshuar jo me shume se gjshte muajt e fundit,ndersa premtimi,ose dokumenti i shtetesise tjeter,jo me shume se dy vitet e fundit.
Afatet e vlefshmerise llogariten mbi bazen e dates se pranimit te dokumenteve nga komisariati i policise vendore,ose perfaqesia diplomatike a konsullore.
Ne ato shtete ku Republika e Shqiperise nuk ka perfaqesi te tilla,veprimet te kryhen ne nje nga perfaqesite e tjera diplomatike apo konsullore shqiptare.
Aplikimet ne çdo rast te kene bashkelidhur edhe faturat e pageses perkatese per sherbimin,si dhe faturat e pagesave te legalizimit te dokumenteve ne perfaqesine diplomatike a konsullore,apo ne Ministrine e Puneve te Jashtme.

12.Te gjithe dokumentet per shtetesine shqiptare (te prodhuara ne Shqiperi, apo ne vende te tjera) pranohen kur jane ne harmoni te plote me njeri tjetrin,pa gabime e pa korigjime.

13.Per sherbimet qe do te kryhen per shtetesine,nga aplikuesi behet pagese me mandatarketimi ne arken e komisariatit ne vleren 5.000 Leke,ne perfaqesine diplomatike apo konsullore ne vleren 30 (tridhjete) dollare USA.Ne kete pagese perfshihet edhe TVSH-ja.Pagesa behet kur dorezohen dokumentet dhe eshte e pakthyeshme.

14.Ne te gjitha rastet dhe nivelet kur korespodenca per shtetesine shqiptare permban dokumente te depozituara nga aplikuesit,ajo te shoqerohet me inventarin e dokumenteve qe permban.

15.Te gjitha aplikimet per shtetesine shqiptare ne komisariate dhe perfaqesi evidencohen ne menyre kronologjike ne regjister te sekretuar (lidhja 5).Nje regjister i tille mbahet edhe ne Zyren e te Huajve te Drejtorise Qendrore te Policise Rendit.

16.Vendimi i Ministrit te Rendit Publik per paraqitjen ose jo te kerkeses se aplikantit per shtetesine prane Presidentit te Republikes eshte individual per te gjithe aplikuesit e moshes mbi 14 vjeç.Nga ana e Drejtorise Qendrore te Policise Rendit,vendimi i Ministrit i behet i njohur zyrtarisht Ministrise se Puneve te Jashtme dhe drejtorise se policise qarkut perkates jo me vone se 15 dite,te cilet nga ana e tyre informojne zyrtarisht te interesuarin ne adresen qe ai ka caktuar per kete qellim.

17.Drejtoria Qendrore e Policise Rendit dergon ne Ministrine e Puneve te Jashtme dhe ne drejtorine e policise qarkut perkates listen emerore te aplikanteve me numrin dhe daten e dekretit te Presidentit.
Ministria e Puneve te Jashtme njoftimin ua dergon te interesuarve ne perfaqesine ku ata kane bere aplikimin.
Drejtoria e policise qarkut listen emerore te aplikanteve me numrin dhe daten e dekretit te Presidentit e dergon per njoftim ne komisariatin respektiv te policise.
Me kerkesen e te interesuarve,komisariati i policise vendore,apo perfaqesia diplomatike konsullore leshon konfirmin zyrtar per permbajtjen e dekretit te Presidentit.Forma dhe permbajtja e konfirmimit pasqyrohet ne lidhjen 4.

18.Lidhjet 1-5 jane bashkelidhur ketij udhezimi dhe perbejne pjese teresore te tij.

19.Udhezimi i Ministrit te Rendit Publik Nr.932 date 10.03.1999 "Per proceduren qe zbatohet dhe dokumentacioni per fitimin,rifitimin dhe heqjen dore nga shtetesia shqipatre",Urdheri i Ministrit te Rendit Publik Nr.1223 date 07.04.2000 "Per nje shtese ne Udhezimin Nr.932 date 10.03.1999 "Per proceduren qe zbatohet dhe dokumentacioni per fitimin,rifitimin dhe heqjen dore nga shtetesia shqiptare"",si dhe Urdheri i perbashket i Ministrit te Rendit Publik (Nr.924 date 03.03.1999) dhe Kryetarit te Sherbimit Informativ Kombetar (Nr.514 date 08.03.1999) "Per procedurat e bashkepunimit per fitimin e shtetesise shqiptare me natyralizim" shfuqizohen.

20.Per zbatimin e ketij udhezimi ngarkohen komisariatet e policise vendore,drejtorite e policise ne qarqe dhe perfaqesite diplomatike e konsullore jashte vendit, ndersa me kontrollin e zbatimit te tij ngarkohen Drejtoria e Pergjithshme e Policise ne Ministrine e Rendit Publik dhe Drejtoria Juridike,Konsullore dhe te Traktateve ne Ministrine e Puneve te Jashtme.

21.Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

MINISTER I PUNEVE TE JASHTME

ARTA DADE

MINISTER I RENDIT PUBLIK

ILIR GJONI

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRI - MINISTRIA E RENDIT PUBLIK